



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetnistva i Tergovine- Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 dhe në Vendimin nr. 5235 dt. 15.07.2021, me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme (NMVM). Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jënë Qytetar të Republikës së Kosovës.

Buxheti i planifikuar për subvencionim për këtë thirrje është **500,000.00 €**. Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të ndahet në tri Lot-e, si vijon:

Loti 1 – Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri 9 punëtorë),
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është **200,000.00 €**

Loti2 – Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtorë),
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është **150,000.00 €**

Loti3 – Ndërmarrjet e mesëm (të punësuar 50 deri 249 punëtorë),
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të mesme është **150,000.00 €**

Aplikimi për Grante për të gjithë qytetarët dhe bizneset bëhet duke përdor Platformën e shërbimeve elektronike eKosova, në linkun ekosova.rks-gov.net

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 26.08.2021 deri më 15.09.2021 ora 16:00.